



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 14.2.2025

Nr: 90

Ora: 14:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË PREFEKTIT TË QARKUT SHKODËR, PËR PERIUdhËN 02 SHKURT-08 SHKURT 2025**

Sot, më datë 14.2.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

**SUBJEKT:** Prefekti i Qarkut Shkodër

**OBJEKT:** Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Prefektit të Qarkut Shkodër për periudhën 02 shkurt-08 shkurt 2025.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Gjatë periudhës 02 shkurt-08 shkurt 2025, Prefekti i Qarkut Shkodër ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- “Analiza vjetore e institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër”, raportuar në datën 3.2.2025 për t’u zhvilluar në datën 6.2.2025.

Nëpërmjet postës elektronike, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Prefektit të Qarkut Shkodër një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Data: 14.2.2025 Nr: 90  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Prefektit të Qarkut Shkodër, për periudhën 02 shkurt-08 shkurt 2025”

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Prefektit të Qarkut Shkodër ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Aktiviteti-Analiza Vjetore e Punës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër” është konfirmuar nga Ministria e linjës vetëm në dt. 3.2.2025, duke e bërë të pamundur raportimin e aktivitetit në sistemin NRI përpara kësaj date. Aktiviteti i mësipërm, ka qenë i programuar të zhvillohet brenda ambienteve të institucionit, brenda orarit zyrtar të punës dhe pa praninë e medias, dhe si një aktivitet i përditshmërisë së punës së institucionit, me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi nga Ministria e linjës dhe përfaqësues së administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër”.*

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstatova se veprimtaria e raportuar jashtë afatit nga Prefekti i Qarkut Shkodër, në kushtet kur nuk ka pjesëmarrje të medias dhe publikut, por vetëm të stafit të institucionit dhe Ministrisë së linjës, në kuadër të detyrave të veta funksionale, në referim të Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar, nuk mbart detyrim për raportim.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Prefektit të Qarkut Shkodër.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**